



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 146/Prot.

Tiranë, më 26.06.2020

PROCESVERBAL

Sot, më datë 26.06.2020, ditën e premte, ora 10.00, Këshilli i Lartë i Prokurorisë zhvilloi mbledhjen plenare të radhës në platformën online, përmes lidhjes Zoom, thirrur nga Kryetari, bazuar në nenet 164 deri 167 të Ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Këshilli u mblodh në prani të anëtarëve si më poshtë:

1. Z. Gent Ibrahimi
2. Z. Alfred Balla
3. Znj. Esmeralda Keshi
4. Z. Tartar Bazaj
5. Z. Bujar Sheshi
6. Z. Kosta Beluri
7. Z. Sandër Beci
8. Z. Vatë Staka

Mungon Znj. Nurihan Seiti

Ishin ftuar për të qenë të pranishëm përfaqësues nga projektet OPDAT, EURALIUS dhe nga Ministria e Drejtësisë.

Mbledhja u zhvillua nën drejtimin e Kryetarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, z.Gent Ibrahimi, i cili, në zbatim të nenit 166 të Ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, pasi verifikoi pjesëmarrjen e anëtarëve, bëri hapjen e saj në kushtet e kuorumit dhe kaloi në paraqitjen e rendit të ditës.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes plenare të datës 12.06.2020



2. Miratimi i projektaktit “Për caktimin e përkohshëm të z.Kreshnik Ajazi, aktualisht prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, si drejtues të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan”.

3. Miratimi i projektaktit “Për caktimin e përkohshëm të znj. Rita Gjati, aktualisht prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës, si drejtuese të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës”.

4. Miratimi i projektaktit “Për caktimin e përkohshëm të z. Arben Dyla, aktualisht prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje, si drejtues të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje”.

5. Miratimi i projektaktit “Për caktimin e përkohshëm të znj. Violeta Shkurta, aktualisht prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, si drejtuese të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier”.

6. Miratimi i projektaktit “Për caktimin e përkohshëm të znj. Arta Marku, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, në funksionin e prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë”.

7. Miratimi i projektaktit “Për caktimin e përkohshëm të znj. Alma Bramo, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Mat, në funksionin e prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës”.

8. Miratimi i projektaktit “Për miratimin e lejes së papaguar për z. Bujar Hoxha, prokuror në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

9. Miratimi i projekt-rregullores “Për transferimin e përkohshëm”.

10. Miratimi i projektaktit “Për transferimin e përkohshëm të një prokurori nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, për një afat njëvjeçar, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec”.

11. Të tjera (pyetje, përgjigje, diskutime).

Z. Ibrahim pyet, nëse ka komente apo shtesa në lidhje me rendin e ditës dhe i jep fjalën Z. Balla.

Z. Balla ka komente për pikën e tetë të rendit të ditës, lidhur me lejen e papaguar për prokurorin Bujar Hoxha. Ky prokuror ka informuar Këshillin e Lartë të Prokurorisë se do të kthehet nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës më datë 08.07.2020. Ai nuk ka kërkuar leje tjetër.



Z. Balla nuk e gjykon të arsyeshme që Këshilli të angazhohet për të dhënë një javë leje të papaguar për këtë prokuror, duke sugjeruar se kjo mund të zgjidhet me drejtuesin e prokurorisë përkatëse: ose duke i dhënë lejen e zakonshme vjetore, ose duke gjetur një zgjidhje tjetër administrative.

Z. Ibrahimi sqaron se e ka futur në rendin e ditë këtë çështje, për të parë mundësinë e gjetjes së një zgjidhjeje administrative nga Këshilli, por mbetet i hapur për ta diskutuar me kolegët, nëse kjo pikë duhet hequr.

Znj. Keshi mendon se ka një problem në rastin e prokurorit Hoxha, pasi ai ka qenë me leje të papaguar që nga fillimi i këtij viti. Leja vjetore është e mundur të merret në varësi të ditëve të punës që një person ka në një vit kalendarik. Në kushtet, kur prokurori Hoxha nuk ka ditë pune për këtë vit, atij nuk mund t'i jepet leje vjetore. Së paku, drejtuesi i prokurorisë e ka të pamundur të japë leje vjetore, në kushtet kur vartësi ka qenë me leje të papaguar, pra nuk ka patur ditë pune. E vetmja leje që mund t'i jepet, është leja e papaguar dhe ne si Këshill legjitimohemi për këtë.

Z. Sheshi është dakord me mendimin e znj. Keshi, duke theksuar se angazhimi i Këshillit për këtë rast duhet të jetë minimal, thjesht, duke i zgjatur për shtatë ditë lejen e papaguar. Madje, nëse nuk ndiqet kjo procedurë, mosmiratimi i lejes së papaguar mund të shkaktonte probleme të tjera me zyrën e financës së prokurorisë.

Z. Balla u kujton kolegëve se ka një ndryshim në lejet administrative të sistemit të prokurorisë, pasi ata i bëjnë lejet vjetore në gusht. Për këtë kategori viti nuk fillon në muajin janar, por në gusht. Këshilli nuk duhet të merret me çështje të thjeshta administrative, prandaj mendon që subjekti ta zgjidhë këtë me drejtuesin e Prokurorisë.

Z. Beluri shprehet se edhe ai nuk e gjykon të arsyeshëm angazhimin e Këshillit për të dhënë leje të papaguar për periudha të shkurtra, në një kohë kur ai e ka shprehur vullnetin e tij për këtë rast, kur ka dhënë miratimin për leje të papaguar afatgjatë, për nevoja familjare. Kjo mund të konsiderohet e përfshirë brenda lejes së papaguar njëvjeçare.

Z. Sheshi këmbëngul që dhënia e lejes njëjavore nuk kërkon ndonjë angazhim të madh nga ana e Këshillit. Kjo bëhet me një votim të thjeshtë. Kush është dakord, le të ngrejë dorën dhe çështja të mbyllet.

Z. Ibrahimi konstaton se ndërhyrjet e z. Balla dhe z. Beluri janë më shumë të natyrës praktike, sesa parimore. Duke qenë se aktet tashmë janë gati, mund të kursehen disa paqartësi që mund t'i shkaktohen prokurorisë përkatëse, prandaj kjo pikë duhet mbajtur në rendin e ditës.

Z. Balla i referohet përvojës me fluturimet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, duke përmendur se ka raste që fluturimi mund të anulohet. Në këto kushte, nuk do të ishte e arsyeshme që Këshilli të diskutonte përsëri, fjala vjen, pas një jave, për të dhënë një javë tjetër leje të papaguar. Ai sugjeron që kjo leje të jetë disi më afatgjatë, deri kur personi të kthehet në atdhe.



Z. Sheshi pyet, nëse ekziston ose është e mundur të vihet ndonjë klauzolë e tillë, pra që leja të jepet deri në ditën kur personi rikthehet në punë ose në ndonjë datë të përafërt. Ai sugjeron që, në vendimin për dhënien e lejes së papaguar, të caktohet: "... nga data 1 korrik deri në ditën e paraqitjes në detyrë".

Z. Ibrahim nuk pajtohet as me propozimin e z. Sheshi, pasi kjo do ta linte çështjen krejtësisht në diskrecionin e prokurorit. Në kushtet kur Këshilli e ka problemin në dorë, duhet miratuar projektakti i paraqitur. Nëse do të përballemi me skenarë të mundshëm, mund t'i konsiderojmë kur t'u vijë koha. Kush është dakord, le të ngrejë dorën, që kjo pikë të mbahet në rendin e ditës,

Miratohet me 6 vota pro. Z. Balla dhe z. Beluri janë kundër.

Z. Ibrahim vijon me pikën e parë të rendit të ditës:

➤ *Miratimi i procesverbalit të mbledhjes plenare të datës 12.06.2020*

Z. Ibrahim pyet, nëse ka pyetje dhe komente. Pasi nuk ka, hedh në votim miratimin e procesverbalit të datës 12.06.2020

Miratohet me 8 vota pro.

Z. Ibrahim vijon me pikën e dytë të rendit të ditës:

➤ *Miratimi i projektaktit "Për caktimin e përkohshëm të z. Kreshnik Ajazi, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, si drejtues të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan".*

Z. Ibrahim i jep fjalën z. Beci për të relatuar në emër të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Z. Beci relaton se, si rezultat i emërimit në Prokurorinë e Posaçme, të drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, më 19.12.2019, ky pozicion mbeti i lirë. Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka caktuar përkohësisht në këtë detyrë, prokurorin Kreshnik Ajazi, me Vendimin nr. 287, dt. 26.12.2019. Këshilli ka zgjatur caktimin e tij të përkohshëm edhe për një afat tjetër tremujor, me Vendimin nr. 88, dt. 25.03.2020

Në nenin 59, pika 1, germa "a" dhe "b", të ligjit 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, parashikohet se: "Pozicioni i magjistratit mund të plotësohet përkohësisht, kur magjistrati në pozicion të përhershëm nuk është në gjendje të ushtrojë funksionin për një periudhë jo më shumë se tremujore, për shkak të caktimit në pozicione të tjera apo arsyeve të tjera të parashikuara në ligj".



Ndërkohë, neni 42/2 i ligjit të sipërcituar, tek “Parimet e transferimit”, përcakton se: “Pozicioni është përkohësisht i lirë, kur magjistrati që e ka atë pozicion në mënyrë të përhershme, për të paktën për 3 muaj, është përkohësisht në pamundësi për të ushtruar funksionin në atë pozicion”.

Së fundi, neni 3 i Rregullores së KLP-së “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve”, miratuar me Vendimin nr. 64, datë 15.04.2019, i ndryshuar, përcakton se: “Prokurori mund të marrë caktim të përkohshëm, në çdo pozicion të të njëjtit nivel ose të një niveli tjetër për të cilin përmbush kërkesat dhe kriteret të parashikuara në ligj për këtë nivel apo pozicion, në të njëjtën prokurori ku ushtron funksionin ose në ndonjë prokurori tjetër. Këshilli i Lartë i Prokurorisë respekton për aq sa është e mundur, vullnetin e prokurorëve gjatë caktimit të përkohshëm”.

Sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, pasi bëri verifikimet përkatëse pranë zyrës së Burimeve Njerëzore, propozon që prokurori Kreshnik Ajazi, i cili plotëson kushtet e vjetërsisë në punë dhe nuk ka masa disiplinore në fuqi, të vijojë me caktimin e përkohshëm në pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, për një periudhë tjetër tremujore, nga 26.06.2020 – 25.09.2020

Z. Ibrahim pyet nëse ka pyetje dhe komente, dhe pasi nuk ka, vijon me leximin e projektaktit dhe e hedh në votim.

Miratohet me 8 vota pro.

(Vendimi “Për caktimin e përkohshëm të prokurorit Kreshnik Ajazi në pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan”, u është njoftuar palëve dhe është publikuar në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë).

Z. Ibrahim vijon me pikën e tretë, të ngjashme me atë pararendëse, të rendit të ditës:

- *Miratimi i projektaktit “Për caktimin e përkohshëm të znj. Rita Gjati, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës, si drejtuese të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës”.*

Z. Ibrahim i jep sërish fjalën z. Beci, për të relatuar në emër të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Z. Beci relaton se, si rezultat i procesit kalimtar të rivlerësimit dhe pas shkarkimit të drejtueses së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës, ky pozicion mbeti i lirë. Për plotësimin e këtij pozicioni, me Vendimin nr. 86, datë 25.03.2020, Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka caktuar përkohësisht prokuroren Rita Gjati, për periudhën nga 27.03.2020-26.06.2020

Z. Beci nuk i citon dispozitat ligjore, pasi ato janë të njëjta në secilin prej relacioneve të paraqitura, si përsa i përket ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e



Shqipërisë”, i ndryshuar, ashtu dhe Rregullores së KLP-së “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve”.

Sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, pasi bëri verifikimet përkatëse pranë zyrës së Burimeve Njerëzore, propozon që prokurore Rita Gjati, e cila plotëson kushtet e vjetërsisë në punë dhe nuk ka asnjë masë disiplinore në fuqi, të vijojë me caktimin e përkohshëm në pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës, për një periudhë tjetër tremujore, duke filluar nga data 27.06.2020-26.09.2020

Z. Ibrahim pyet nëse ka pyetje dhe komente, dhe pasi nuk ka të tilla, vijon me leximin e projektaktit, pasi rasti është i ngjashëm me pikën e dytë të rendit të ditës. Më pas, e hedh në votim.

Miratohet me 8 vota pro.

(Vendimi “Për caktimin e përkohshëm të prokurores Rita Gjati, në pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës”, u është njoftuar palëve dhe është publikuar në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë).

Z. Ibrahim vijon me pikën e katërt, të ngjashme, të rendit të ditës:

- *Miratimi i projektaktit “Për caktimin e përkohshëm të z. Arben Dyla, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje, si drejtues të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje”.*

Z. Ibrahim i jep sërish fjalën z. Beci për të relatuar në emër të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Z. Beci relatton se, si rezultat i procesit kalimtar të rivlerësimit dhe pas shkarkimit nga ana e KPK-së, pozicioni i Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje, mbeti i lirë. Për të plotësuar vendin përkohësisht të lirë, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, me Vendimin nr. 87, datë 25.03.2020, ka caktuar në këtë pozicion, prokurorin z.Arben Dyla.

Pasi citohet e njëjta bazë ligjore si në pikat pararendëse të rendit të ditës, propozohet që prokurori Arben Dyla, i cili plotëson kushtet e vjetërsisë në punë si dhe nuk ka asnjë masë disiplinore në fuqi, të vijojë me caktimin e përkohshëm në pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë, për një periudhë tjetër tremujore, duke filluar nga data 01.07.2020 - 30.09.2020

Z. Ibrahim pyet nëse ka pyetje dhe komente. Me këtë rast, ai bën një koment për vëzhguesit e jashtëm që ndjekin mbledhjen përmes faqes së internetit, duke thënë se Këshilli i Lartë i Prokurorisë vazhdon të përdorë instrumentin e caktimit të përkohshëm, për të shmangur problemin e krijuar nga veprimi i ligjit të vetingut, i cili ka qenë shkak i shkarkimit të thujtës shumicës së drejtuesve të prokurorive në rrethe.



Së shpejti, KLP pritet të miratojë një rregullore për ngritjen në detyrë të prokurorëve, e cila do të jetë dhe mjete standard për emërimin e drejtuesve të prokurorive. Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka mbajtur parasysh që të ketë vijimësi në caktimin e përkohshëm të drejtuesve të prokurorive, përmes rinovimit të këtij instrumenti.

Më tej, z. Ibrahim i vijon me leximin e projektaktit të propozuar më sipër, pa cituar bazën ligjore, pasi është e ngjashme me pikat e tjera, dhe e hedh në votim.

Miratohet me 8 vota pro.

(Vendimi "Për caktimin e përkohshëm të z. Arben Dyla, si drejtues të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje", u është njoftuar palëve dhe është publikuar në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë).

Z. Ibrahim i vijon me pikën e pestë të ngjashme të rendit të ditës:

- *Miratimi i projektaktit "Për caktimin e përkohshëm të znj. Violeta Shkurta, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, si drejtuese të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier".*

Z. Ibrahim i jep sërish fjalën z. Beci për të relatuar në emër të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Z. Beci relatton se, si rezultat i procesit të rivlerësimit kalimtar, pas shkarkimit nga ana e KPK-së, pozicioni i drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, mbeti i lirë. Për të plotësuar vendin përkohësisht të lirë, Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka caktuar në këtë pozicion, znj. Violeta Shkurta. Ai citon vendimet e marra nga Këshilli: Vendimin nr.54, datë 01.04.2019; Vendimin nr. 111, datë 27.06.2019; Vendimin nr. 187, datë 27.09.2019; Vendimin nr.288, datë 26.12.2019 dhe Vendimin nr. 85, datë 25.03.2020, të Këshillit. Baza ligjore është e njëjtë si në rastet e ngjashme.

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, pasi bëri verifikimet përkatëse pranë zyrës së Burimeve Njerëzore, propozon që prokurore Violeta Shkurta, e cila plotëson kushtet e vjetërsisë në punë si dhe nuk ka asnjë masë disiplinore në fuqi, të vijojë me caktimin e përkohshëm në pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, për periudhën tremujore, duke filluar nga data 01.07.2020 - 30.09.2020

Z. Ibrahim i pyet nëse ka pyetje dhe komente dhe vijoi me leximin e projektaktit, duke mos përsërisur bazën ligjore, pasi është e ngjashme me pikat e mësipërme. Më pas e hedh në votim.

Miratohet me 8 vota pro.



(Vendimi "Për caktimin e përkohshëm të znj. Violeta Shkurta, si drejtuese të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier", u është njoftuar palëve dhe është publikuar në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë).

Z.Ibrahimi vijon me çështjen e gjashtë të ngjashme të rendit të ditës:

- *Miratimi i projektaktit "Për caktimin e përkohshëm të znj. Arta Marku, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, në funksionin e prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë".*

Z. Ibrahimi i jep sërish fjalën z. Beci për të relatuar në emër të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Z. Beci relatton se Këshilli i Lartë i Prokurorisë, me Vendimin nr. 89, dt. 25 .03.2020, në kuadër të plotësimit të vendeve të lira pranë Prokurorisë së Gjykatës së Apelit Tiranë, ka caktuar përkohësisht në këtë pozicion, prokuroren Arta Marku. Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka mbajtur parasysh faktin se është i pamundur plotësimi i këtij vendi me prokurorë të tjerë, për shkak të mungesës në organikën e prokurorive më të afërta, si dhe për shkak të ngarkesës në punë të disa prej tyre. Sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, bazuar në dispozitat ligjore dhe në rregulloren e lartpërmendur, pasi bëri verifikimet përkatëse pranë zyrës së Burimeve Njerëzore, propozon që prokurore Arta Marku, e cila plotëson kushtet e vjetërsisë në punë si dhe nuk ka asnjë masë disiplinore në fuqi, të caktohet përkohësisht në pozicionin e prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për një periudhë tjetër tremujore, duke filluar nga data 01.07.2020 - 30.09.2020

Z. Ibrahimi pyet nëse ka pyetje dhe komente dhe vijon me leximin e projektaktit, duke mos përsërisur bazën ligjore, pasi është e ngjashme me pikat e mësipërme. Më pas e hedh në votim.

Miratohet me 8 vota pro.

(Vendimi "Për caktimin e përkohshëm të znj. Arta Marku, në funksionin e prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë", u është njoftuar palëve dhe është publikuar në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë).

Z.Ibrahimi vijon me çështjen e shtatë të ngjashme të rendit të ditës:

- *Miratimi i projektaktit "Për caktimin e përkohshëm të znj. Alma Bramo, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Mat, në funksionin e prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës".*

Z. Beci relatton se, për plotësimin e vendeve të lira në prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, Këshilli ka marrë një sërë vendimesh, si: Vendimin nr.186, datë 27.09.2019; Vendimin nr. 290, datë 26.12.2019 dhe Vendimin nr.91, datë 25.03.2020, duke caktuar



përkohësisht znj. Alma Bramo, prokurore e emëruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Mat, si prokurore pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës.

Ai citon të njëjtat dispozita si në rastet e mësipërme, duke përsëritur se Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, pasi bëri verifikimet përkatëse pranë zyrës së Burimeve Njerëzore, propozon që prokurore znj. Alma Bramo, e cila plotëson kushtet e vjetërsisë në punë si dhe nuk ka asnjë masë disiplinore në fuqi, të vijojë me caktimin e përkohshëm në pozicionin e prokurorit pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, për një periudhë tjetër tremujore, duke filluar nga data 29.06.2020 - 30.09.2020.

Z. Ibrahim pyet nëse ka pyetje dhe komente.

Rreth kësaj çështjeje u diskutua:

Znj. Keshi sqaron se ka disa komente që nuk kanë të bëjnë me relacionin e përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, por me pasojat e miratimit të këtij propozimi. Prokuroria e Matit, që prej muajit shtator 2019, ka vetëm një prokuror që është dhe drejtues i kësaj prokurorie. Në kushtet që Këshilli përballlet me vështirësi (që nuk varen nga ne), siç është procesi i vetingut, numri i prokurorëve për t'u emëruar është i ulët. Por, konkretisht, situata në Mat varet vetëm nga vendimmarrja e Këshillit. Fakti që kemi një prokuror të vetëm në një zyrë prokurorie, parimisht dhe konkretisht, cënon të drejtat e këtij prokurori.

Duke argumentuar qëndrimin e saj kundër propozimit konkret për prokuroren Alma Bramo, ajo thekson se e tërë baza ligjore, ku Këshilli bazohet për caktimin e përkohshëm, i lejon njëkohësisht çdo prokurori, edhe lejen e paguar. Gjithashtu, çdo prokuror ka të drejtën e kompensimit të orëve jashtë orarit, në ditët e fundjavës apo ditët e festave zyrtare, deri në 200 orë gjatë një viti kalendarik (për orët e punës mbi këtë limit, drejtuesi është i detyruar ta kompensojë me leje).

Në kushtet kur kemi vetëm një prokuror në këtë prokurori (Mat), mbetet objektivisht e pamundur që magjistrati ta përfitojë këtë të drejtë. Për këto arsye, ajo është kundër propozimit të paraqitur.

Z. Ibrahim ndan të njëjtin qëndrim me znj. Keshi, duke sjellë në vëmendje të Këshillit që prokuroritë e rretheve Mat dhe Përmet, kanë nga një prokuror të vetëm. Nëse në Përmet është më e vështirë (sepse nuk ka një prokuror të emëruar në detyrë, që është caktuar përkohësisht diku tjetër), në Mat kemi një prokuror të emëruar dhe problemi mund të zgjidhet, duke ndërprerë caktimin e përkohshëm të prokurores Bramo (në Durrës) dhe kthimin e saj në pozicionin ku ka emërimin, pra në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Mat.

Z. Bazaj është dakord me dy parafolësit dhe mendon që prokurores Alma Bramo t'i jepet një bonus për gadishmërinë e treguar. Por, ai nuk është dakord që zyra e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Mat, të mbetet me një prokuror të vetëm, pasi askush nuk do të mund të mbante i vetëm të gjithë ngarkesën e punës.



Z. Sheshi është dakord me argumentet logjike të znj. Keshi, por i qëndron mendimit të shprehur në relacion, duke qenë për përsëritjen e afatit të caktimit të përkohshëm në Durrës, për këtë prokurore. Ai deklaron se e ndjen si detyrim moral ndaj saj, për gadishmërinë dhe përkushtimin e treguar në një rast tjetër, duke vënë në dukje se është përgjegjësia e Këshillit që nuk arrin të plotësojë prokurorinë e Matit, me emërime të reja.

Z. Ibrahim kujton, gjithashtu, se prokurorja Alma Bramo ka treguar gadishmëri dhe vullnet, duke shërbyer për një vit në prokurorinë e rrethit Pukë. Megjithatë, duke pranuar që situata në prokurorinë e Matit nuk ka zgjidhje tjetër, ai i propozon Këshillit që të rishikojë qëndrimin për vazhdimësinë e caktimit të përkohshëm të saj në Durrës. Ai parashtron të votohet për dy qëndrime:

1. Për shtesën e afatit tremujor të caktimit të përkohshëm të znj. Alma Bramo, pranë prokurorisë së Durrësit (propozuar nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës);
2. Që Këshilli të heqë dorë nga vendimmarrja dhe prokurorja Bramo të kthehet automatikisht në prokurorinë e Matit.

Miratohet me 5 vota pro, pika e parë. Kundër ish-in znj. Keshi, z. Bazaj dhe z. Ibrahim.

Z. Ibrahim vijon me leximin e projektaktit “Për caktimin e përkohshëm të znj. Alma Bramo, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Mat, në funksionin e prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës”. *(Vendimi, pasi u është njoftuar palëve, është publikuar në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë).*

Z. Ibrahim vijon me çështjen e tetë të rendit të ditës, që u vendos të trajtohej nga Këshilli:

- *Miratimi i projektaktit “Për miratimin e lejes së papaguar për z. Bujar Hoxha, prokuror në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë”.*

Z. Ibrahim pyet nëse ka pyetje dhe komente, por meqenëse i gjithë diskutimi u zhvendos në fillim të mbledhjes, ku u diskutua nëse kjo pikë duhej mbajtur në rendin e ditës, hedh në votim miratimin e projektaktit për dhënien e lejes së papaguar edhe për një afat të shkurtër, për z. Bujar Hoxha, prokuror në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Miratohet me 7 vota pro. Kundër, z. Beluri.

(Vendimi për dhënien e lejes së papaguar, edhe për një afat të shkurtër, për z. Bujar Hoxha, prokuror në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, pasi u është njoftuar palëve, është publikuar në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë).

Z. Ibrahim vijon me çështjen e nëntë të rendit të ditës.

- *Miratimi i projekt-rregullores “Për transferimin e përkohshëm të prokurorëve”*



Z. Ibrahim risjell në vëmendje të Këshillit, relacionin e paraqitur nga Komisioni i Karrierës në mbledhjen e mëparshme, dhe fton z. Beci për ta rilexuar.

Z. Beci relatton, duke iu referuar konkretisht mungesës së prokurorëve në Prokurorinë e Pogradecit. Këshilli i Lartë i Prokurorisë duhet t'i krijojë vetes mundësinë për të përdorur institutin e transferimit të përkohshëm, parashikuar nga neni 46 i ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Përmes tij, jo vetëm do të plotësohej një vend i lirë, por do të përmirësohej dukshëm edhe puna e prokurorit në Prokurorinë, ku ai do të transferohej, pasi instrumenti i transferimit të përkohshëm parashikon dhe një bonus financiar që nuk e parashikon instrumenti i caktimit të përkohshëm.

Relacioni i referohet Kreut 4, nga neni 42-46 i ligjit të lartpërmendur, ku trajtohet gjerësisht instituti i transferimit. Transferimi, si koncept, përdoret si për lëvizjet në vendet e lira në mënyrë të përkohshme, ashtu dhe për lëvizjet në vendet e lira në mënyrë të përhershme. Transferimi pa pëlqim aplikohet vetëm në rastin e vendeve përkohësisht të lira. Relatori e shpjegon këtë instrument në mënyrë të hollësishme, duke përfshirë në shpjegim herë skemën e delegimit, herë transferimin me dhe pa pëlqim, herë lëvizjen paralele, të ndërlidhura ose jo këto me njëra tjetrën, sipas rastit.

Pavarësisht se nuk është një kërkesë eksplicite e ligjit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës mendon që Këshilli duhet t'i referohet një rregulloreje, e cila do të hartohet bazuar në dispozitat ligjore, ku të përcaktohen rregullat dhe kriteret për transferimin e përkohshëm të prokurorëve.

Duke iu referuar transferimit të përkohshëm të prokurorit, Komisioni i propozon Këshillit ta ndajë këtë pjesë nga dispozitat e ligjit që përfshijnë edhe lëvizjet paralele, dhe ta trajtojë më vete për ta përdorur si një instrument të përshtatshëm për nevojat që lindin nga krijimi i vendeve të lira për shkak vendimmarrjes së organeve të vetingut si dhe nga fakti që caktimi i përkohshëm nuk mund të konsiderohet i përshtatshëm për të zgjidhur çdo situatë të krijuar.

(Relacioni i plotë ndodhet i protokolluar në dosjen e mbledhjes plenare).

Z. Ibrahim pyet, nëse ka pyetje dhe komente.

Rreth kësaj çështjeje u diskutua:

Z. Sheshi nuk është dakord me hartimin e një rregulloreje të posaçme për transferimin e përkohshëm. Këshilli po angazhohet për hartimin e një rregulloreje, e cila mbështetet në nenin 46 të ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Neni në fjalë përmban gjashtë pika, nga të cilat vetëm dy janë për transferimin e përkohshëm të prokurorëve të juridiksionit të përgjithshëm, ndërsa tri pika të tjera janë për transferimin e përkohshëm të prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme. Pika 6 flet për afatin



maksimal të transferimit të përkohshëm. Hartimi i një rregulloreje për dy pika të një neni (46) të ligjit të sipërcituar, që janë shumë të qarta në dispozitat ligjore, është i panevojshëm.

Ai i referohet nenit 118 të Kushtetutës, i cili e autorizon Këshillin të nxjerrë akte nënligjore, duke sugjeruar se, meqenëse Këshilli ka marrë përsipër të hartojë një rregullore për lëvizjet paralele dhe transferimet, në këtë rregullore mund të shtohet edhe një nen për transferimin e përkohshëm.

Ai vëren se janë 18 pika në këtë projekt-rregullore, që i japin një pamje të ndërlikuar transferimit të përkohshëm, ndërkohë që ky instrument na jep mundësinë që ne ta përdorim në raste të rralla, për më tepër, për shkak edhe të ekzistencës së skemës së delegimit. Praktikisht, kur nuk ka prokurorë në skemën e delegimit, dhe një zyrë prokurorie ka nevojë t'i transferohet një prokuror për nevojat e saj, atëherë ne si Këshill duhet t'u referohemi kritereve që thotë ligji, duke kërkuar kandidatë për transferim vullnetar (ose me detyrim, në rastin e mosdhënies së pëlqimit) në prokuroritë më të afërta dhe/ose me ngarkesë mesatare më të ulët.

Z. Ibrahim sqaron se Këshilli ndodhet në kushtet e dispozitave të Kreut 4 të ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Nëse neni 42 flet për parimet e transferimit, nenet pasuese 43, 44, 45, 46, paraqesin format e ndryshme të transferimit, ku transferimi ndahet në: transferim të përkohshëm (neni 46) dhe transferim të përhershëm (nenet 43 dhe 44). Neni 46 përfshin dy nënkategoritë: transferimin e përkohshëm me pëlqim dhe transferimin e përkohshëm pa pëlqim.

Gjithsesi, shihet se në ligj ka një mungesë të theksuar të elementit procedural. Lëvizja paralele është thjesht një emërtim ndryshe për transferimin e përhershëm, ndërsa lidhur me skemën e delegimit, ai vlerëson se kjo do të kërkonte shumë kohë, prandaj e konsideron të nevojshëm instrumentin e transferimit të përkohshëm.

Duke i qëndruar mendimit se është e nevojshme të hartohet një rregullore për transferimin e përkohshëm, ai ia rijep fjalën z. Sheshi, për komente të mëtejshme.

Z. Sheshi sjell paraprakisht në vëmendje të Këshillit opinionin e disa juristësh, sipas të cilëve puna e KLP-së është shumë operative, por ky organ "nuk i mban shumë parasysh ligjet". Sigurisht, ne nuk jemi dakord me këtë opinion, pasi Këshilli e ka kusht bazë, zbatimin e ligjit.

Por, konkretisht, ndarja që i bëhet në këtë projekt-rregullore, neni 46, nga pjesa tjetër e neneve të Kreut 4 të ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, e nxjerr Këshillin pa bazë ligjore për miratimin e vetë kësaj rregulloreje.

Ai përsërit se, për një nen (46) që e shpreh shumë qartë edhe procedurën që duhet të ndiqet në rastin e transferimeve paralele, nuk është i nevojshëm hartimi i një rregulloreje të re me 18 pika. Në rregulloren e përgjithshme që do të hartohet për lëvizjet paralele, mund të shtohen pikat përkatëse edhe për transferimin e përkohshëm: qoftë me pëlqim, qoftë pa pëlqim!



Përfundimisht, meqenëse kjo rregullore u fut në rendin e ditës pa iu nënshtruar diskutimit në mbledhjen informale, ai mendon që kjo të tërhiqet nga mbledhja plenare.

Z. Bazaj shprehet se kjo çështje, meqenëse nuk është diskutuar në mbledhjen informale, duhet të hiqet nga rendi i ditës. Ai e konsideron të nevojshëm një diskutim më të gjatë, para se projekt-rregullorja të kalojë për miratim në Këshill, duke qenë dakord edhe me argumentet e z. Sheshi.

Znj. Keshi është për hartimin e një rregulloreje për transferimin e përkohshëm, pasi vlerëson se lëvizja paralele dhe ngritja në detyrë janë instrumente, të cilët i duhen Këshillit për të vepruar normalisht. Ndërsa, lidhur me transferimin e përkohshëm, Këshilli duhet ta përdorë këtë instrument, kur nuk ka mjete të tjera. Përfundimisht, ajo është e mendimit që Këshilli duhet të ketë një rregullore për këto raste.

Z. Ibrahim kërkon ndërprerjen e mbledhjes për shkak të një problemi teknik dhe pas rifillimit të saj, pyet nëse ka komente.

Rreth kësaj çështje u diskutua:

Z. Balla merr fjalën, duke theksuar se Këshilli ka detyrimin ligjor të nxjerre akte nënligjore, sipas nenit 174/1, pika “a”, të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Nëse do të diskutohej dhe miratohej një rregullore e tillë, ky veprim do ta përmbushte edhe këtë detyrim ligjor. Akte të tilla nënligjore, sikurse është kjo projekt-rregullore, edhe pse duken burokratike dhe përdoren rrallë, janë shumë të vlefshme në raste të veçanta. Për këtë ai i referohet edhe praktikës së KLGJ-së, që e ka një rregullore të tillë.

Z. Beluri mendon se transferimi i përkohshëm është i lidhur ngushtë me caktimin e përkohshëm, prandaj e konsideron të nevojshme që, në rregullore, të bëhet qartë dallimi ndërmjet caktimit të përkohshëm dhe transferimit të përkohshëm. Projekt-rregullorja për transferimin e përkohshëm, t’i bashkëngjitet “Rregullores për caktimin e përkohshëm”. Transferimi i përkohshëm është një mjet në duart e Këshillit, për t’u aplikuar në raste të veçanta, me procedura të shkurtuara. Ai nuk i sheh të arsyeshme procedurat e shpalljeve apo aplikimeve për transferimin e përkohshëm. Komisioni i Karrierës është ai që zgjedh se kush do të jetë prokurori që do të transferohet, pa qenë e nevojshme shpallja për aplikime të ndryshme, qofshin me pëlqim, qofshin pa pëlqim. Përfundimisht, ky draft t’i bashkëngjitet rregullores ekzistuese për caktimin e përkohshëm dhe mjafton.

Z. Staka shprehet se nevojitet më shumë kohë, që anëtarët e Këshillit të njihen më mirë me projekt-rregulloren, dhe propozon që miratimi i saj të shtyhet për një seancë tjetër.

Z. Ibrahim është për hartimin e një rregulloreje të tillë të posaçme. Ai komenton se, ndryshe nga z. Sheshi, i cili është për tërheqjen e projektaktit, z. Bazaj dhe z. Staka e mbështesin miratimin e



këtij projektakti, por duan më shumë kohë për ta studiuar. Ndërkohë, z.Beluri është me variantin që ky draft t'i bashkëngjitet "Rregullores për caktimin e përkohshëm".

Kryetari shprehet i bindur që koncepti i transferimit meriton të trajtohet në një rregullore, më me hollësi nga çfarë e ka parashikuar ligji. Ai saktëson në mënyrë të përmbledhur se koncepti i transferimit përbëhet nga dy komponentë: transferimi i përhershëm dhe transferimi i përkohshëm. Të dy komponentët bëhen si me pëlqim, ashtu dhe pa pëlqim. Transferimi i përhershëm me pëlqim e ka emrin "lëvizje paralele", kurse transferimi i përhershëm pa pëlqim e ka emrin "transferim pa pëlqim". Ndërkohë, transferimi i përkohshëm i ka të përfshira në një nen të vetëm, të dy komponentët: me pëlqim dhe pa pëlqim.

Nisur nga ajo që përmendi z.Balla, sipas nenit 174/1, germa "a", të ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Këshilli ka autorizimin e drejtpërdrejtë për nxjerrjen e një akti nënligjor për transferimin e përhershëm, por mungesa e referencës së drejtpërdrejtë për transferimin e përkohshëm, është thjesht një harresë rastësore e ligjvënësit.

Ai mendon se fillimisht shtrohet pyetja, nëse kjo do të jetë pjesë e një rregulloreje më vete apo e integruar në rregulloren për skemën e delegimit dhe/apo për caktimin e përkohshëm?!

Pas komenteve të shkëmbyera midis disa anëtarëve të Këshillit, ai pajtohet me mendimin se duhen bërë disa rregullime dhe propozon ta tërheqë këtë pikë nga rendi i ditës, për të lënë hapësirë diskutimi në mbledhjen informale, para se të diskutohet në mbledhjen plenare të radhës. Me këtë rast, ai u kujton anëtarëve që, nëse kanë vërejtje për thelbin e projekt-rregullores, le t'i paraqesin me shkrim pranë Komisionit të Karrierës.

Z. Sheshi i rikthehet argumentit të tij, se projekt-rregullorja për transferimin e përkohshëm i referohet nenit 46 të ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ku dy pika janë pikërisht për transferimin e prokurorëve të juridiksionit të përgjithshëm, ndërsa tri të tjera janë për prokurorët e Prokurorisë së Posaçme. Të bësh një rregullore me 18 pika, vetëm për 2 pika të një neni (46), të cilat janë të parashikuara shumë qartë në ligjin e sipërcituar, është e panevojshme. Por, duke iu referuar nenit 118 të Kushtetutës, që autorizon Këshillin për nxjerrjen e akteve nënligjore, meqë Këshilli e ka marrë përsipër ta hartojë një rregullore të tillë, ai propozon që rregullores për lëvizjen paralele t'i shtohet një nen apo dy nene për transferimin dhe kaq!

Z.Balla propozon që, nëse nuk do të miratohet kjo projekt-rregullore, Këshilli t'i referohet më mirë nenit 45 (për skemën e delegimit), se nenit 46 (për transferimin) të ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikë e Shqipërisë", i ndryshuar.



Znj. Keshi ndan parimisht mendimin se trajtimi i çështjeve është më i thjeshtë, nëse çdo mekanizëm ka një rregullore të posaçme, qoftë për skemën e delegimit, qoftë për transferimin, caktimin e përkohshëm, lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë e kështu me radhë.

Z. Bazaj propozon që ky draft t'u vihet në dispozicion edhe prokurorive përkatëse, për t'u njohur me mendimin e tyre, përpara se Këshilli të dalë me një vendim. Fundja, prokurorët janë pala që preket nga ky akt.

Z. Ibrahim pajtohet me mendimin e parafolësit. Pasi konstaton se, parimisht, të gjithë janë për një rregullore, nisur nga fakti se disa prej anëtarëve kanë qëndrime të ndryshme dhe rezerva për formulimin e disa neneve, ai propozon që drafti të diskutohet paraprakisht në një nga mbledhjet informale të Këshillit dhe më pas të kalojë për miratim në mbledhjen plenare.

Z. Ibrahim hedh në votim heqjen e kësaj pike nga rendi i ditës.

Miratohet me 7 vota pro. Z.Beluri ishte kundër.

Z.Ibrahim vijon me çështjen e dhjetë të rendit të ditës.

- *Miratimi i projektaktit "Për transferimin e përkohshëm për një afat 1-vjecar, të një prokurori nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec".*

Z. Ibrahim sqaron që, edhe pse Këshilli nuk ka një rregullore për transferimin e përkohshëm, këto procedura janë kryer duke iu referuar drejtpërdrejt ligjit.

Z. Ibrahim ka një pyetje për Komisionin e Zhvillimit të Karrierës, nëse e ka marrë në shqyrtim këtë projektakt për ndonjë arsye, apo thjesht ngaqë ka pasur kërkesë të posaçme nga drejtuesja e Prokurorisë së rrethit Pogradec. Një kërkesë të ngjashme me Pogradecin, ka patur edhe nga drejtuesja e Prokurorisë së Kukësit.

Z. Beci sqaron se Komisioni i Zhvillimit të Karrierës u është drejtuar për dhënie pëlqimi, prokurorive më të afërta me rrethet e lartpërmendura, që janë përkatësisht Korça dhe Tropoja, por deri tani nuk ka patur asnjë reagim prej tyre. Komisioni e konsideroi si më emergjent rastin e prokurorisë së rrethit të Pogradecit, nisur edhe nga analiza se transferimi i prokurorit në fjalë nuk e çënon punën e prokurorisë së Korçës. Ndërkohë, në pritje të një reagimi nga prokuroritë e Tropojës dhe të Kukësit, Komisioni do të trajtojë me qetësi edhe ngarkesën e Prokurorisë së Kukësit.

Duke iu rikthyer gjendjes në Prokurorinë e Pogradecit, Z. Beci përmend faktin se, ndonëse në organikë kjo zyrë ka katër prokurorë, aktualisht në detyrë janë vetëm dy, pasi një prokuror u emërua në Prokurorinë e Posaçme, kurse tjetri dha dorëheqjen. Në kushtet e mungesës në skemën e delegimit, parashikuar në nenin 45 të ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve



në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Këshilli duhej të ndërhynte, pasi situata në Prokurorinë e Pogradecit është emergjente. Këshilli është i detyruar të veprojë me instrumentin e transferimit të detyrueshëm, duke transferuar përkohësisht pa pëlqimin e tij, prokurorin Gjergji Ceka.

Nga ana tjetër, Prokuroria e Korçës ka në organikë trembëdhjetë prokurorë, prej të cilëve aktualisht vetëm njëmbëdhjetë ushtrojnë detyrën. Nga ana e Këshillit është kërkuar edhe mendimi i drejtueses së kësaj prokurorie, edhe pëlqimi i prokurorëve të caktuar pranë saj. Në mungesë të dhënies së pëlqimit nga ana e prokurorëve, pavarësisht miratimit të dhënë nga drejtuesja, Komisioni i është referuar nenit 46, pika 2 dhe pika 6, të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka gjykuar se prokurori Gjergji Ceka i plotëson kriteret e vendit të punës dhe kushtet ligjore, duke qenë prokurori me përvojën më të pakët në prokurorinë më të afërt. Prandaj, Komisioni propozon transferimin e tij në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec, për një periudhë njëvjeçare, duke filluar nga data 26.06.2020-25.06.2021 (*Relacioni i plotë ndodhet në dosjen e protokolluar të mbledhjes plenare*).

Z. Ibrahim pyeti nëse kishte pyetje apo komente. Meqë nuk kishte, ai vijoi me leximin e projektvendimit, mbështetur në propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës, që z. Gjergji Ceka, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, të transferohet përkohësisht, pa pëlqimin e tij, për të ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec.

Pas leximit të projektvendimit u shkëmbyen mendime midis z.Ibrahimi, z. Sheshi dhe z. Beluri, lidhur me datën e fillimit të efekteve financiare, ku u saktësua dhe u vendos që ato të fillojnë njëkohësisht me fillimin e ushtrimit të detyrës, më 01.07.2020

Z. Ibrahim hedh në votim projektvendimin me propozimin përkatës për ndryshimin e datës.

Miratohet me 8 vota pro.

(Vendimi “Për transferimin e përkohshëm, për një afat njëvjeçar, të prokurorit Gjergji Ceka, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec”, njoftuar palëve, ndodhet në dosjen e mbledhjes plenare si dhe i publikuar në faqen zyrtare të Këshillit).

Z. Ibrahim kalon në pikën e fundit të rendit të ditës, “Të tjera”.

Ai u kujton anëtarëve të Këshillit projekt-memorandumin që u ka shpërndarë, një material ky i paraqitur nga Ministria e Drejtësisë, i cili ka të bëjë me caktimin e një prokurori ndërlidhës pranë EUROJUST, në Hagë. Këshilli ka shpallur procedurat e aplikimit për këtë pozicion, mbi bazën e kërkesës së Prokurorit të Përgjithshëm, dhe deri tani ka administruar dy kandidatura.



Ai sugjeron që, një nga çështjet për t' u diskutuar në mbledhjen e ardhshme plenare, të jetë qëndrimi i KLP-së ndaj këtij projekt-memorandumi.

Në përfundim, duke mos patur pika të tjera për diskutim, Kryetari e deklaroi mbledhjen të mbyllur.

Mbajtësi i procesverbalit

(Sonila Çeliku)

KRYETAR

Gent Ibrahimi

Shënim:

Në këtë procesverbal janë/nuk janë të pasqyruara pasaktësitë e konstatuara eventualisht nga anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Pasaktësitë e vërejtura janë reflektuar me urdhër të Kryetarit, Nr. — Datë — 2020/me vendim të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Nr. — datë — (bashkëlidhur, kopjet e dokumenteve). Procesverbali u miratua në mbledhjen e radhës të KLP-së, datë 08/07/2020

Procesverbali të arkivohet.

PËRGJEGJËSI I SEKTORIT TË SHËRBIMEVE ADMINISTRATIVE

Frederik Sulisufi